



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:223100

Datë: 22.11.2021

Numri i dokumentit: 02454305

2021:234853

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit L.A., për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.3 lidhur me par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1557/21, e dt.19.10.2021, në shqyrtimin fillestar, të mbajtur më datë 29.10.2021, në prani të Prokurorit të Shtetit Ardian Emini, të dëmtuarit B.V. dhe të pandehurit me mbrojtësin të tij me autorizim Av. Besmir Rrahmani, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 22.11.2021, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri L.A., nga i ati K., e ëma N., e gjinisë M., i lindur me datë ... në fshatin ... Komuna Shtime, me vendbanim në Ferizaj, rruga “...” nr..., me numër personal ..., ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë për ndonjë veprë penale, ndaj tij nuk udhëhiqen procedura tjera penale, gjendet në paraburgim nga dt. 04.10.2021 gjer më tani me dt. 29.10.2021.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë 04.10.2021, rreth orës 23:45, në rrugën “...” në Ferizaj saktësisht në kafiterin “...” me qëllim të frikësimit dhe shkaktimit të ankthit e kanos seriozisht të dëmtuarin B.V.i, zyrtar policor lidhur me punën e tij zyrtare, në atë mënyre që deri sa zyrtari policor kishte qenë në kryerjen e detyrës zyrtare duke iu shqiptuar tiketat për mos respektim të masave anti-covid, i pandehuri fillimisht e fyen me fjalë më banale e pastaj e kanos të dëmtuarin me fjalët “**ty ka me ta marr shpirtin, a e din se kush jam unë, kam me të zhdukë, ka me të vra ty dhe kam me ta zhduk familjen**”, me ç’rast te dëmtuarit i ka shkaktuar ndjenjën e frikës, ankthit dhe të pasigurisë.

- me këtë ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 181 par. 3 lidhur me par. 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Andaj, Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 44, 69, 70, dhe neni 181 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe në bazë të neneve 365, 453, 463, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të pandehurin e :

G J Y K O N

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 /gjashtë/ muajve, i cili dënim konform neni 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me dënim në gjobë në shumën prej 2000 € /dymijë Euro/, dënimin e shqiptuar me gjobë i pandehuri ka për ta paguar në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e përcaktuar në asnjë mënyrë, sipas neni 43 par. 3 të KPK-së, i njëjti dënim do t’i shëndrrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t’i llogaritet një (1) ditë burgim.

Në dënimin e shqiptuar do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt.04.10.2021 gjer me dt. 29.10.2021, kur me aktvendim të veçantë të pandehurit i ndërpritet masa e paraburgimit

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro (njëzet euro), si dhe në emër kompensimin të Viktimave të Krimit shumën prej 30 € /tridhjetë euro/, që të dyja shumat brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

I dëmtuari B.V. nga Ferizaj, ka hequr dorë nga kërkesa pasurore-juridike.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm me aktakuzën e saj PP/II.nr.1557/21, të dt.19.10.2021, ka ngarkuar të pandehurin për veprën penale Kanosja nga neni 181 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së dhe ka kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitura për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar publik me datë 29.10.2021, në të cilën prokurori shtetit, lexoj aktin akuzues dhe gjyqtari pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, konform nenit 246 par. 4 të KPPK-së, të pandehurit i ofroj mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarojë i pafajshëm.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar publik ka deklaruar se: e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas të gjitha pikave të saj, duke shtuar se ndihem i penduar, jam i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë, më vjen keq që më ka ndodh rasti i cili ka qenë i atçastshëm pasi me personin zyrtar-me policin nuk kam pasur asgjë të keqe pasi që as jemi njohur mes vete por unë atë ditë isha pak nën ndikim të alkoolit dhe për këtë ka ardhur deri te ky rasti, tani të dëmtuarit i kërkoj falje publike dhe po premtoj se në të ardhmen nuk do të përsëris këso lloj vepra penale apo të ngjashme, është hera

e parë që kam ra ndesh me ligjin dhe besoj se do të jetë edhe hera e fundit dhe më tepër nuk kam çka të shtoj .

Prokurori i shtetit me rastin e paraqitjes së mendimit të tij, ka deklaruar se: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të , pasi që një pranim i tillë nga ana e të pandehurit u bë vullnetarisht në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 248 të KPPRK-së, në mbështetje të provave dhe fakteve që përmban aktakuza , i propozoj gjykatës që të bëj pranimin e fajësisë së të akuzuarit, të njëjtin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj një sanksion të paraparë me ligj, ndërsa sa i përket masës së paraburgimit le të vendos gjykata sipas diskresionit të saj .

Mbrojtësi i të pandehurit Av.Besmir Rrahmani lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se: pas pranimin të fajësisë nga ana e të mbrojturit tim me rastin e shqiptimit të dënimit nga ana e gjykatës që këtë rrethanë të ketë parasysh si rrethanë veçanërisht lehtësuese, po ashtu edhe kërkim faljen nga ana e të pandehurit .

I dëmtuari B.V. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se: e përkrahi në tërësi fjalën e prokurorit të shtetit, i bashkëngjitem ndjekjes penale, ndërsa kërkesë pasurore juridike,nuk paraqes pasi që nuk kam pasur ndonjë shpenzim rreth rastit.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPRK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit si: raporti i Oficerit me nr. 2021-CF-2053 i dt. 05.10.2021, raportet e policit hetues të dt.05.10.2021, deklaratat e të dëmtuarit ajo e dt. 05.10.2021 e dhënë në polici dhe ajo e dt.07.10.2021 e dhënë në prokurori, deklaratat e të pandehurit ajo e dhënë në polici me dt.05.10..2021 dhe ajo në prokurori me dt. 06.10.2021,deklarata e dëshmitarëve të dhëna në prokurori me dt.07.10.2021 dhe 08.10.2021, si dhe shkresat të cilat gjenden në lëndë.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin*

fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Kanosja nga neni 181 par. 3 lidhur me par.2 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar edhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra e kryerjes së veprës penale për çka dhe i pandehuri u shpallë fajtor dhe ju shqiptua dënim siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese përkatësisht që në shqyrtimin fillestar i pandehuri ka pranuar fajësinë, pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, se për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, kërkim faljen publike që i ka bërë të dëmtuarit, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej kësi lloj vepre penale, ndërsa në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-ës, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të theksuarave më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL
2021:234853 e datës 22.11.2021

Zyrtare Ligjore
Kimete Bytyqi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.

Numri i lëndës: 2021:223100
Datë: 22.11.2021
Numri i dokumentit: 02454305